

**Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”
Fakulteti i Filologjisë
Shkolla doktorale: Programi Letërsi**

PUNIM DOKTORATE

Summary

Title: "The study of Ymer Shkreli's literary work"

We have accomplished our doctoral thesis "The study of Ymer Shkreli's literary work" with a commitment and a good will to the subject matter. Although we tried to be as objective as we had to do with a favorite author, maybe we could not even get away from the subjectivity.

Ymer Shkreli is one of the most productive and qualitative authors of contemporary Albanian literature, especially what was happening in Kosovo during the years 1960-1990, when he wrote. He is a complex author, as in the style of the writing, the form of his literary texts, as well as the ideas and topics of his works. He wrote almost in all forms of literary writing, such as novel, short story, drama, poetry, children's literature (novel, poetry and poem for children) and autobiography. Known more widely as a playwright, we share our thought that the quality of Ymer Shkreli's work is more in his novel, which is one of the most special in Albanian literature.

We have divided our thesis into eight chapters, through which we aimed to analyze the specifics of the literary texts of Ymer Shkreli, such as those that are common to a group of works, as well as those that are specific to one a certain work of this writer. In addition to the first chapter, which is more of a prelude to our study of the literary work of this author, in all subsequent chapters we have conducted internal analyzes and interpretations of his works, both in the thematic and conceptual plan, as well as in formal and stylistic terms. As we have said before, in this doctoral thesis we have used the model of integral interpretation as the methodology of our research work. We thought and believing that by this way of interpretation we will be closer to revealing Ymer Shkreli's work for our study needs as well as his knowledge of others (readers and potential scholars of tomorrow) since we are dealing with an author whose work is quite a bit analyzed by Albanian criticism and literary studies.

In the first chapter we talked about the Albanian literature that was developed in Kosovo during the years 1960-1990, which can be described as a productive triad in our literature and one of the most qualitative periods of Albanian literature in general. During these years, our author, Ymer Shkreli, has also written, and through this chapter we tried to show the cultural atmosphere in which he wrote and his position in the context of literary developments. We have mentioned that we are dealing with a literary development with a very short history, emphasizing that Albanian literature developed in the territory of Kosovo is an integral and inseparable part of Albanian literature and culture in general. Likewise, in this chapter we have spoken in short lines about the names of writers, their literary works, as well as the forms and ideas that have prevailed over these years in Kosovo Albanian literature.

In the second chapter, we have talked about Ymer Shkreli's literary works, starting from his rich bio-bibliography to stop in his artistic works, such as prose, drama, poetry, literature for children and his autobiography.

The third chapter we have analyzed the literary creation of our writer, where we have dealt with both formal and conceptual features. We have found that in the formal aspect, the most prominent features of this author stand in his prose, concretely novel. In this aspect, it is good to say that we are dealing with a writer who wrote different forms and types of novels and short stories, not in a single writing style, as many authors did. This unfaithfulness to a single form seems to be intentional action by the author to show his narrative possibilities in many perspectives and model of art writings. Meanwhile, in the conceptual features we have

emphasized the concept of death, tragedy and the idea of revolt against power and might, which emerges from a many works of this author. The concept and theme of death is more than present in Ymer Shkrel's literary work. It is presented once in its real dimension, once in a fantastic and filled with the philosophical dimension of narrative meditation on it. Linked to the motive of death, tragically dimension is more viewed in Ymer Shkrel's literary works. The tragedy, as aesthetic and thematic categories, includes most of the works of this author.

In this chapter, as well as a feature of his works we have also seen their relation to Albanian history and folklore. In creating the thematic structure and ideas in his artistic works, Ymer Shkreli has utilized the Albanian history, the historical material, to create his literary text. This interaction is accomplished either by taking historical essences and transforming them into an integral part of a creative artistic product, or by taking historical personalities, historical records for which they become a thematic initiation for a historical review of the literary work. As for the relation with folklore, we have concluded that it is one of the thematic source of Albanian literature. It has been used by the best authors of our literature, creating thematic works by different folk songs. And Ymer Shkreli is in this way too. In some of his works, there is clearly a relationship with folklore, whether in the intertextual context, as retrieval of folk motifs and their re-dimensioning in literary text.

In the artistic works of Ymer Shkrel we have noticeable revolt, as a conceptual dimension derived from the interpretation of the text. This revolt manifests itself as a social response to public order in our country during the second half of the 20th century when it was under the Yugoslav communist regime. The revolt is most pronounced in the dramatic texts of this author. The fourth chapter of our doctoral thesis refers specially to Ymer Shkrel's literary prose, starting with his first novel, "The Death in the Fresh Air," which we have described as a novel with philosophical elements. There are short, associative and striking sentences that differ from other novels by Ymer Shkrelit, in which however we have longer and more explanatory words. The narrative work "Kosovar Rhapsody" has been described as a quartet novel, as there are four novels in it that can be read and function as special works. They are named: "The war of Troy", "Sleeping Hero", "Shpendkeqja" and "Zeka the unfortunate". All four texts can be read and understood separately, but also as part of a narrative quartet. It is interesting to say that in the narrative plan "Kosovar Rhapsody" is a specific work that proves our knowledge about the forms of great romance art, since we are usually taught to see a book with a collection of stories and poems, but a book with four specific novels in it, not that we are used to seeing it. We regard the novel "The Point" as a polyphonic confession, adding that it is Ymer Shkrel's longest novel and the most multifaceted in terms of his ideas and motives. This novel motivates the title itself, through which the narrative forms and narratives, as well as its ideas and themes, can be disaggregated. For the novel "The Man in the tail" we have said that there is an ironic discourse about the war, where the disagreement of disparate goes to the absurd levels. Meanwhile, concrete irony goes for World War II, as a universal enmity that has involved all people. As a distinguishing sign of this novel we can emphasize the overthrow of the other, the foreigner, in this case of the Italian soldier, who is the main character and narrator in this novel. We have analyzed "Azgal" as a novel with a mark of a national metaphor, in which we have symbolic and associative discourse. It is a narrative work with a historical subtext and has three lines of narration. We have seen the novel "Handbook for another world" as an eclectic narrative and as one of Ymer Shkrel's most complex novels in which the different forms and styles of writing are combined. "The bridge of hell" is a tragic story and one of the best narrative works in Albanian literature. We can conclude that with the thematic findings, the message it gives, the

psychological and emotional dimension, the beautiful descriptions of the environments and characters, we can say that the novel "The bridge of hell" is one of the masterpieces of our literature. This narrative creation of Shkreli, perhaps not so well analyzed noticed as deserved by Albanian literary critics. This novel take an important place in the hierarchy of the novel genre in our literary art. The novel "Dead Autumn" has been analyzed as a novel of love and as a novel with elements of family drama. Meanwhile, the short stories of Ymer Shkreli, summarized in the work "The devil's plant", have carefully looked at their stylistic and thematic plan. There we met the metaphorical story where symbolic and national metaphors are at the center of discourse, then the fantastic story, the character story, the psychological and social story, the story of absurd colors, the family drama expressed through this genre, the story of war and the consequences, the personal one that has the creator's motive, the writer and his struggles to find a tale, the lunatic story, and the story where the author demonstrates the ironic and critical discourse with religion, as well as Islamic even Christian ones.

The fifth chapter of our doctoral thesis is about the dramatic texts of Ymer Shkreli. From what we have read and interpreted, we can conclude that we are dealing with one of the best Albanian literary dramatists. He certainly is the most productive Albanian playwright in the history of Albanian drama writing. Though Ymer Shkreli can not be qualified only with productive epithets, since his texts have high qualities, both in terms of their ideas, as well as in the construction of the style and manner of discourse that characterizes the literature of this author. In his dramatic creation we find the drama with allegorical discourse, with a discourse with the presence of metaphors and associations, through which the parable of a tyranny ("Black Zeka goes to Babylon"). Then, we have the drama of the unveiling of Illyrian antiquity ("Illyrian Trilogy: Pirrua, Teuta, Genci"), the drama with elements of absurdity, such as the dramatic texts "Rain guard", "The little theater of Deli Uka", "Alterego and "Paradox", drama with elements of realistic literature, such as the texts "Mother Goes to Paradise", "No Pasaran" and "Shpend Sokoli, son of the Sokol Shpendi". Also, in the dramatic works of this author, we find three possible subdivisions of the texts based on the story structured and positioning of the characters in it. So we can say that here we have a lot of situations in the drama, such as "Mother Goes to Paradise", "Ulpiana 518" and "No Pasaran", the character drama, as we can see "Illyrian Trilogy", "Sokol Shpend's Shpend Sokoli" and "The little theatre of Deli Uka", as well as the drama of ideas, such as the "Rain guard", "Paradox", "Missal" and "Zeka goes to Babylon". The fantastic view, as the characterizing sign of Ymer Shkreli's literature, is also present in his dramatic texts, where as an example we can take the short drama "Alterego". Meanwhile, in the conceptual aspect, in the dramas of Ymer Shkreli, we have two conceptual lines, such as historical ideas, through which the author did not disclose the historical events as it is said in Albanian historiography, but through the literary text, creates what can be termed a historical reshuffle or revision, which is the quality of modern dramaturgy. Meanwhile, as a second level, are the ideas of revolt, social criticism, and reaction to the mighty. The revolt in Y. Shkreli's dramatic texts appears in response to a political system, such as the Yugoslav communist regime. In the sixth chapter of our Ph.D. we examine the poetic works of this author. In his works we have find the political poem ("Balcanica"), the work of meditative lyricism, where we see the variety of forms in a poetic works ("Febris"), the deep lyrical and meditative discourse in a poetic text ("The Diary of a robber"), contemplative discourse and philosophical world-view in a poetic work (" I ask for a death punishment ") and poetic discourse for the others, different peoples ("Romanella").

In the seventh chapter we have talked about children's literature, which does not lack Ymer Shkreli's extensive literary opus. This author wrote the novel for children, children short stories and poetry and poem for children. We have said that the novel "Bali Katravella" is a humorous novel for children, with basic points of comic situation. We have concluded that it characterizes a discussion where situations develop as if in an indicative narrative, with fantastic literary and magical presence in the description of objects and beings that are faced with their characters and actions. In the short stories of children, we have seen the subtypes of different styles of narration, which are part of what can be called the identity of children's literature. So we have a education narration, a fantastic story, with a wonderful and surprising presence, such as two essential categories of fantasies and literature dedicated to the younger ages. Likewise, we have a comic story, which emerges through the narration about childrens. Likewise, in the work of Ymer Shkreli's work, written for kids, we also see the lyric diary (The diary of Lec Pazheci). It has the structure of a poetic book, written as a lyric journey, dedicated for of children's. Lec Pazheci is the hero of this work, written with a infantile sense, which is convenient for the age of children's. The fabulous discourse and story about beauty are found in poetic work "Princess of Dukagjini", which can be read as a fragmented poem. The poetic collection, that was written especially for children's, where we have many forms and ways of writing, is "Give me back my spring". While the poem written in a discourse that resembles legend, as an identity sign for children's literature, we have in the work "The prince of the mountains."

The eighth and last chapter is exclusively about the autobiographical book of Ymer Shkrel, which is the only work with a pseudonym (Lec Pazheci), and not its real name. Ymer Shkrel's autobiographical narrative presents three reports that are relevant to the narrator: self-report; relationship with family members and relationship with society. We have did it as a chapter in itself because the autobiographical narrative of Ymer Shkrel is unique also within his literary work, but also within Albanian literature in general, especially in the form of autobiographical Albanian writing.

This doctorate has given us a pleasure of reading and interpreting, pointing out that when a scholar has to do with quality writers, however productive volumes it may be, is the literary text, the stylistic value of his form and its polysemantic view, what does not make the research ever boring. We also had this sensation in the study of Ymer Shkreli's literary work.

Rezyme

Titulli: Studimi i veprës letrare të Ymer Shkrelit

Punimin tonë të doktoratës “Studimi i veprës letrare të Ymer Shkrelit” e kemi realizuar me një përkushtim dhe me një vullnet të mirë ndaj lëndës së trajtuar. Edhe pse jemi munduar të jemi sa më shumë objektiv, duke qenë se kemi pasur të bëjmë me një autor të preferuar, ndoshta edhe nuk kemi mundur t’i ikim edhe aq shumë subjektivitetit.

Ymer Shkreli është njëri nga autorët më produktiv dhe më cilësor që kishte dhe ka letërsia bashkëkohore shqiptare, veçanërisht ajo që zhvillohej në Kosovë gjatë viteve 1960-1990, kur edhe shkroi ky autor. Ai është autor kompleks, si në planin e stilit të shkrimit, formës së teksteve të tij letrare, po ashtu edhe në atë të ideve dhe temave që dalin prej veprave të tij. Shkroi pothuajse në të gjitha format e shkrimit letrar, si romanin, tregimin, dramën, poezinë, letërsinë për fëmijë (romanin, poezinë dhe poemthin për fëmijë) dhe autobiografinë. I njohur e i përfolur më shumë si dramaturg, ndajmë bindjen se cilësia e veprës së Ymer Shkrelit qëndron më shumë te romani i tij, që është një nga më të veçantit në letërsinë shqipe.

Punimin tonë e kemi ndarë në tetë kapituj, përmes të cilëve kemi synuar që t’i zërthejmë specifikat e teksteve letrare të Ymer Shkrelit, si ato që janë të përbashkëta për një grup veprash të tij, po ashtu edhe ato që janë të veçanta për një vepër të caktuar të këtij shkrimtari. Përpos në kapitullin e parë, që është më shumë një parahyrje në studimin tonë për veprën letrare të këtij autori, në të gjitha kapitujt e radhës kemi bërë analiza dhe interpretime të brendshme të veprave të tij, si në planin tematik e ideor, po ashtu edhe në atë formal e stilistik. Siç e kemi thënë më parë, në këtë punim tonin të doktoratës e kemi përdorur modelin e interpretimit integral, si metodologji e punës sonë kërkimore. Kemi menduar dhe besuar se me këtë mënyrë të interpretimit do të jemi më afër shpalimit të veprës së Ymer Shkrelit për nevojat tona studimore, si dhe njohjes së saj për të tjerët (lexuesit dhe studiuesit e mundshëm të së nesërme), meqë kemi të bëjmë me një autor, vepra e të cilit është fare pak e trajtuar nga kritika dhe studimet letrare shqiptare.

Në kapitullin e parë kemi folur për letërsinë shqipe, që është zhvilluar në Kosovë gjatë viteve 1960-1990, që mund të cilësohet si një tredakadësh frytdhënës në letrat tona dhe një nga periudhat më kualitative të letërsisë shqipe në përgjithësi. Gjatë këtyre viteve ka shkruar edhe autori ynë, Ymer Shkreli dhe përmes këtij kapitulli jemi munduar që ta tregojmë atmosferën krijuese në të cilën shkroi ky autor dhe pozicionin e tij në kuadër të zhvillimeve letrare. E kemi cekur se kemi të bëjmë me një zhvillim letrar me një historik tejet të shkurtë, duke potencuar se letërsia shqipe e zhvilluar në territorin e Kosovës është pjesë integrale dhe e pashkëputshme e letërsisë dhe kulturës shqipe në përgjithësi. Po ashtu, në këtë pjesë kemi folur në pika të shkurta për emra krijuesish, veprash të tyre letrare, si dhe forma dhe ide që kanë mbizotëruar gjatë këtyre viteve në letërsinë shqipe të Kosovës.

Në kapitullin e dytë kemi folur për krijimtarinë letrare të Ymer Shkrelit, duke u nisur nga bio-bibliografia e tij tejet e pasur për t’u ndalur në pika të shkurta në vepra të tij të caktuara artistike, si në prozë, dramë, poezi, letërsi për fëmijë dhe autobiografinë e tij. Kapitulli i tretë i kushtohet zërthimit të veçorive në krijimtarinë letrare të këtij shkrimtari, ku i kemi trajtuar si veçoritë formale, po ashtu edhe ato ideore. Kemi konstatuar se në aspektin formal, veçoritë më të spikatura të këtij autori qëndrojnë te proza e tij, konkretisht romani. Në këtë aspekt, është e udhës ta themi se kemi të bëjmë me një prozator e romancier që shkroi forma dhe tipa e nëntipa të ndryshëm të romaneve dhe tregimeve, duke mos i qëndruar besnik një

mënyre të vetme shkrimi, siç ngjet te shumë autorë. Kjo jobsnikëri ndaj një forme të vetme duket të jetë veprim i qëllimshëm nga ana e autorit, për t'i treguar mundësitë e tij rrëfyese në shumë perspektiva e modele shkrimi. Ndërkaq, te veçoritë ideore i kemi potencuar konceptin e vdekjes, tragjikes dhe idenë e revoltës ndaj pushtetit dhe ndaj të pushtetshmit, që del në një sërë veprash të këtij autori. Koncepti dhe tema e vdekjes është më se e pranishme në veprën letrare të Ymer Shkrelit. Ajo paraqitet herë në dimensionin e saj real, herë në atë fantastik e herë e mbushur me dimensionin filozofik të meditim narrativ mbi të. I ndërlidhur me motivin e vdekjes, padyshim se është elementi i tragjikes në krijimtarinë letrare të Ymer Shkrelit. Tragjikja, si kategori estetike dhe tematike, i përfshinë shumicën e veprave të këtij autori.

Në këtë kapitull, po ashtu si një veçori të veprave të tij e kemi parë edhe relacionin e tyre me historinë dhe folklorin shqiptar. Në krijimin e strukturës tematike dhe ideve në veprat e tij artistike, Ymer Shkreli e ka shfrytëzuar bukur mirë historinë shqiptar, materialin historik, për ta krijuar tekstin e tij letrar. Kjo ndërlidhje realizohet qoftë duke i marrë esencat historike dhe duke i shndërruar ato në pjesë përbërëse të produktit kreativ artistik, qoftë duke i marrë personalitetet historike, të dhënat historike për të cilët bëhen brumë tematik për një rishikim historik në veprën letrare.

Ndërsa, sa i përket relacionit me folklorin kemi theksuar se ai është njëri prej gurrave tematike të letërsisë së shkruar shqipe. Atë e kanë shfrytëzuar autorët ndër më të mirët të letërsisë sonë, duke krijuar vepra me bazament tematik nga këngët e ndryshme popullore. Në këtë mes, pa dyshim që hyn edhe Ymer Shkreli. Në disa nga veprat e tij shihet qartë relacioni me folklorit, qoftë në planin intertekstual, si rimarrje e motiveve folklorike dhe ridimensionim i tyre në tekstin letrar, qoftë si mënyrë ligjërimore e ngjyrim i diskursit letrar me diskursin folklorik. Në krijimtarinë artistike të Ymer Shkrelit e kemi të vërejtshme revoltën, si dimension ideor që del prej interpretimit të tekstit. Kjo revoltë shfaqet si reagim shoqëror ndaj rendit publik në vendin tonë gjatë pjesës së dytë të shekullit XX, kur ishte nën thundrat e regjimit komunist jugosllav. Revolta është më së shumti e theksuar në tekstet dramatike të këtij autori.

Kapitulli i katërt i punimit tonë flet enkas për prozën letrare të Ymer Shkrelit, duke u nisur nga romani i tij i parë “Vdekja në ajër të pastër”, të cilin e kemi cilësuar si roman me elemente filozofike. Në të kemi fjali të shkurta, asociative e goditëse, që e dallojnë nga romanet e tjera të Ymer Shkrelit, në të cilat megjithatë kemi fjalë më të gjata e më sqaruese. Veprën narrative “Rapsodi kosovar” e kemi cilësuar si kuartet romanësor, duke qenë se brenda saj kemi katër romane, që mund të lexohen dhe funksionojnë si të veçanta, e që janë “Lufta e Trojës”, “Heroi në gjumë”, “Shpenkeqja” dhe “Zeka i zi”. Të katër tekstet mund të lexohen dhe kuptohen edhe të ndara, por edhe si pjesë e një kuarteti narrativ. Është me interes të thuhet se në planin narrativ “Rapsodi kosovare” del të jetë një vepër specifike që e vë në provë njohjen tonë rreth formave të artit të madh romansor, meqë zakonisht jemi mësuar të shohim libër me përmbledhje tregimesh e poezish, por libër që i përmbledh katër romane të veçanta në të, nuk është se jemi mësuar ta shohim. Romanin “Pikëpjekja” e kemi vlerësuar si rrëfim polifonik, duke shtuar se është romani më i gjatë i Ymer Shkrelit dhe më i shumështrësuar në aspekt të ideve e motive që dalin prej tij. Këtë roman e motivon vetë titulli, përmes së cilit mund të zbërthehen si format e pikëshikimit narrative, po ashtu edhe idetë e tematika e tij. Për romanin “Njeriu në bisht” kemi thënë se ka një diskurs ironik për luftën, ku ballafaqimi i të pangjashmëve shkon deri në nivelet e absurdit. Ndërkaq, ironia konkrete shkon për Luftën e Dytë Botërore, si një katrahurë universale që i ka përfshirë të gjithë njerëzit. Si shenja dalluese të këtij romani mund ta potencojmë sipërtheksimi i tjetrit, të huajit, në këtë rast të ushtarit italian, i cili është kryepersonazh dhe narrator në këtë roman. “Azgalin” e kemi analizuar si roman me një shënjim

të një metafore nacionale, në të cilin nuk mungon diskursi simbolik e asociativ. Është një vepër narrativ me një nëntekst historik dhe ka tri linja të rrëfimit. Romanin “Doracak për një botë tjetër” e kemi parë si rrëfim eklektik dhe si njërin ndër romanet më komplekse të Ymer Shkrelit, në të cilin gërshetohen dhe kombinohet format dhe stilet e ndryshme të shkrimit. “Ura e xhehenemit” është një rrëfim tragjik dhe njëri nga veprat narrative më cilësore në letërsinë shqipe. Për të mund të konstatojmë se me gjetjet tematike, me mesazhin që e jep, me dimensionin psikologjik e emotiv, me përshkrimet e bukura të ambienteve dhe karaktereve të personazheve, mund të themi se romani “Ura e xhehenemit” është një nga kryeveprat që i ka letërsia jonë. Ky krijim narrativ i Shkrelit, ndoshta edhe jo aq i trajtuar e i vënë re aq sa e meriton, zë një vend të rëndësishëm në hierarkinë e zhanrit të romanit në letrat tona. Romani “Vjeshta e vdekur” e kemi analizuar si roman të dashurisë dhe si roman me elemente të dramës familjare. Ndërkaq, tregimet e Ymer Shkrelit, të përmbledhur në veprën “Bima e dreqit”, i kemi vështruar me kujdes në planin e tyre stilistik dhe tematik. Aty kemi hasur tregimin metaforik, ku simbolika e metaforika nacionale janë në qendër të diskursit, pastaj tregimin fantastik, tregimin e personazhit, tregimin psikologjik e social, tregimin me ngjyime të absurdit, dramën familjare të shprehur përmes këtij zhanri, tregimin me temë luftën dhe pasojat e saj, tregimin që ka për temë gjakmarrjen, atë personal që ka për motivin krijuesin, shkrimtarin dhe mundimet e tij për gjetjen e një rrëfimi, tregimin lunatik dhe tregimin ku autori e demonstroi diskursin ironik e kritik me religjionin, si atë islam, po ashtu edhe atë të krishterë.

Kapitulli i pestë i punimit tonë merret me tekstet dramatike të Ymer Shkrelit. Nga ajo që kemi lexuar dhe kemi interpretuar, mund të konstatojmë se kemi të bëjmë me njërin nga dramaturgët më të mirë të mbarë letërsisë shqipe. Pa dyshim se është dramaturgu më prodhimtar shqiptar në historinë e shkrimit të dramës shqipe. Megjithëse, Ymer Shkreli nuk mund të cilësohet vetëm me epitelin prodhimtar, meqë tekstet e tij kanë kualitete të larta, si në rrafsh të mbarështrimit të ideve të tyre, njashtu edhe në ndërtimin e stilit dhe të mënyrës së ligjërimit, që e karakterizon letërsinë e këtij autori. Te krijimtaria e tij dramatike e hasim dramën me diskurs alegorik, me një ligjërim me prani të metaforave dhe asociacioneve, përmes të cilave shpaloset shëmbëlltyra e një tiranie (“Zeka i zi udhëton në Babibilon”). Pastaj, kemi hasur dramën e shpalimit të antikitetit ilir (“Trilogji ilire: Pirrua, Teuta, Genci”), dramën me elemente të absurdit, siç janë tekstet dramatike “Roja e shiut”, “Teatri i vogël i Deli Ukës”, “Alterego” e “Paradoks”, dramën me elemente të letërsisë realiste, siç janë tekstet “Nëna shkon në parajsë”, “No pasaran” e “Sokol Shpendi i Shpend Sokolit”. Po ashtu, në krijimtarinë dramatike të këtij autori i hasim edhe tri nënndarje të mundshme të teksteve në bazë të mbarështrimit të rrjedhës së ngjarjes dhe pozicionimeve të karaktereve në të. Kështu që, mund të themi së këtu në masë të madhe e kemi të pranishme dramën e situatave, siç është ta zëmë “Nëna shkon në parajsë”, “Ulpiana 518” e “No pasaran”, dramën e personazhit, siç janë ta zëmë “Trilogjia ilire”, “Shpend Sokoli i Sokol Shpendit” e “Teatri plak i Deli Ukës”, si dhe dramën e ideve, siç janë ta zëmë “Roja e shiut”, “Paradoks”, “Meshari” e “Zeka udhëton në Babilon”. Fantastikja, si shenjë karakterizuese e letërsisë së Ymer Shkrelit, është e pranishme edhe në tekstet e tij dramatike, ku si shembull për këtë mund ta marrim dramën e shkurtë “Alterego”. Ndërkaq, në aspektin ideor, te dramat e Ymer Shkrelit, i kemi hasur dy rrafshë ideore, siç janë idetë historike, përmes të cilave autori nuk e shpalos të ndodhurën historike ashtu siç thuhet në historiografinë shqiptare, por përmes tekstit letrar, e krijon atë që mund të cilësohet si ridimensionim apo rishikim historik, që është cilësi e dramaturgjisë moderne. Ndërkaq, si rrafsh i dytë, janë idetë e revoltës, kritikës shoqërore dhe reagimit ndaj të pushtetshmit. Revolta në tekstet dramatike të Y. Shkrelit shfaqet si reagim ndaj një sistemi politik, siç ishte ai komunist jugosllav.

Në kapitullin e gjashtë të tezës sonë të doktoratës shqyrtohen veprat poetike të këtij autori. Në krijimtarinë e tij e kemi hasur poemën politike (“Balcanica”), veprën e lirikave medituese, ku i shohim shumëllojshmëritë e formave në një përmbledhje poetike (“Febris”), diskursin e thellë lirik e meditativ në një tekst poetik (“Ditari i hajnit”), ligjërimin meditues dhe botëkonceptimin filozofik në një vepër poetike (“Kërkoj dënim me vdekje”) dhe ligjërimin poetik për tjetrin (“Romanella”).

Në kapitullin e shtatë flitet enkas për letërsinë për fëmijë, që nuk i mungon opusit të gjerë letrar të Ymer Shkrelit. Ky autor e shkroi romanin për fëmijë, tregimet për fëmijë dhe poezi e poema për fëmijë. Romanin “Bali Katravella” e kemi cilësuar si roman humoristik për fëmijë, me pikë qëndrim bazik te situatat komike. Kemi shtuar se atë e karakterizon diskursi përrallor, ku situatat zhvillohen sikurse në një përrallë të treguar, me prani të fantastikes letrare dhe të magjishmes në përshkrimin e objekteve dhe qenieve që përballen me personazhet dhe veprimet e tyre. Te tregimi për fëmijë kemi hasur nëntipa e stile të ndryshme rrëfimi, që janë pjesë e asaj që mund të quhet si shënjim identitar i letërsisë për fëmijë Kështu që, në të kemi tregimin edukativ, tregimin fantastik, me prani të mrekullueshmes dhe të befasishme, si dy kategori qenësore të fantastikes dhe letërsisë që u dedikohet moshave minore. Po ashtu, e kemi edhe tregimin komik, që del përmes rrëfimit për çapkenllëqet e fëmijëve. Po ashtu, në opusin e krijimtarisë së Ymer Shkrelit, të shkruar për vocërrakët, e shohim edhe ditarin lirik (“Ditari i Lec Pazheci”). Ai ka natyrën e një libri poetik, të shkruar si një rrugëtim lirik në përkushtim të fëmijëve. Lec Pazheci është subjekt e hero lirik i kësaj vepre, të shkruar me një sens infantil, që është adekuate për moshën së cilës i drejtohet. Diskursin përrallor dhe rrëfimin për të bukurën e gjejmë te vepra poetike “Princesha e Dukagjinit”, që mund të lexohet edhe si poemë e fragmentarizuar. Përmbledhjen poetike, të shkruar nergut për fëmijë, ku kemi shumësi formash e mënyrash shkrimi, e shohim te “Kthema pranverën time”. Ndërsa, poemën e shkruar me një diskurs që i ngjanë legjendës, si shenjë identitare e letërsisë për fëmijë, e kemi te vepra “Princi i Bjeshkëve të Nemuna.”

Kapitulli i tetë dhe i fundit i kushtohet vetëm librit autobiografik të Ymer Shkrelit, që është e vetmja vepër të cilën e shkroi me pseudonim (Lec Pazheci), e jo me emër të tij real. Rrëfimi autobiografik i Ymer Shkrelit na i shpërfaq tri raporte të qenësishme të subjektit rrëfyes: raporti me veten; raporti me familjarët dhe raporti me shoqërinë. E kemi lënë si kapitull në vete për shkak se rrëfimi autobiografik i Ymer Shkrelit është unikat edhe në kuadër të krijimtarisë së tij letrare, por edhe në kuadër të letërsisë shqipe në përgjithësi, veçanërisht në formën e shkrimit autobiografik shqiptar.

Ky punim doktrate na ka dhuruar një kënaqësi leximi dhe interpretimi, duke na bërë të potencojmë se kur një studiues ka të bëjë me shkrimtarë cilësorë, sado voluminozë e produktivë që mund të jenë, është teksti i tyre letrar, vlera stilistike e formës së tij dhe bota e tij polisemantike, ajo që nuk ia bën asnjëherë të mërzitshëm hulumtimin. Këtë ndjesi e patëm edhe në studimin e veprës letrare të Ymer Shkrelit.